

Pyetje	Përgjigje 1	Përgjigje 2	Përgjigje 3	Përgjigje 4	Përgjigje 5
Nëse $g = 10 \text{ m/s}^2$ , atëherë njeriu me masën 75 kg ka peshën prej:	A) 7,5 N	B) 75 kg	C) 750 kg	D) 7500 N	E) 750 N
Në një sistem i cili kryen oscilime harmonike, energjia e përgjithshme:	A) është në funksion të kohës	B) nuk varet nga amplituda e oscilimit	C) ndryshohet proporcionalisht me katrorin e amplitudës së oscilimit	D) zvogëlohet linearisht gjatë kohës	E) asnjë prej përgjigjeve nuk është e saktë
Ndryshimi periodik i presionit dhe dendësia e molekulave në një medium material shfaqet kur në të përhapen:	A) valë elektromagnetike	B) valët mekanike	C) alfa thërmi	D) rreze të dritës	E) fotonet
Cila prej dukurive të theksuara nuk ka të bëjë me valët mekanike	A) difraksioni	B) shpërndarja	C) përthyerja	D) polarizimi	E) refuzimi i kufirit në mes dy mjediseve
Gjatë kalimit të valeve të zërit nga mjedisi me impendans të vogël akustik në mjedis me impendans më të madh akustik:	A) pjesa më e madhe e duajve të zërit reflektohet (refuzohet)	B) pjesa më e madhe e duajve të zërit absorbohet (thithet)	C) duajt e zërit tërësisht transmetohen (barten)	D) shkaktohet rezonanca akustike	E) shfaqet polarizimi
Gjatë kalimit të tingullit nga timpani i veshit deri te membrana bazilare, reflektimi (refuzimi) i zërit është i vogël, për shkak të:	A) dukurisë së rezonancës akustike	B) tre osikulat e veshit që veprojnë si sistem të losteve	C) dallimet e vogla në impendaset akustike të mjediseve	D) dallimet e mëdha në impendaset akustike të mjediseve	E) forma e membranës bazilare
Në procesin e dëgjimit, valët e tingujve duke u shtrirë nëpër shtyllën ajrore të veshit të jashtëm, me presionin e tyre veprojnë mbi timpanin ajrorë dhe ajo fillon të oscilloj me amplitudë proporcionale të:	A) amplitudës së presionit të tingullit	B) impendansit të tingullit në ajër	C) gjatësia e kanaliz të veshit	D) dimensionet e timpanit të veshit	E) temperatura e mjedisit
Në organin e dëgjimit, veshi i mesëm luan rolin e:	A) përforcuesit linear	B) rezonator	C) shëndërrues i energjisë mekanike në energji elektrike	D) shëndërrues i energjisë elektrike në mekanike	E) ngulfatës
Gjatë metodës diagnostifikuese me ultra zë, kontakti i sondës dhe sipërfaqes së lëkurës realizohet përmes zhelit, që të :	A) zmadhohet dallimi në impendanseve akustike mes sipërfaqeve kontaktuese	B) zvogëlohet dallimi në impendanseve akustike mes sipërfaqeve kontaktuese	C) evitohet dukuria e elektrolizës	D) zmadhohet impendansi akustik i lëkurës	E) shkaktohet dukuria e potencialit aksional
Cila prej metodave të theksuara diagnostifikuese nuk ka efekte të dëmshme shëndetësore mbi pacientin:	A) Ehografia	B) Scintigrafia	C) Radiografia	D) Tomografia Pozitron emetuese	E) Tomografia Mono fotonike emetuese
Eksperimentalisht është dëshmuar se viskoziteti i gjakut është më i vogël në enët e gjakut me diametër më të vogël. Kjo dukuri njihet si:	A) hemokrit	B) efekti i murit të enës së gjakut	C) tensioni sipërfaqësor	D) emboli e gazit	E) efekti i Doplerit
Rrjedha turbulente e gjakut nëpër sistemin kardiovaskular:	A) nuk ndodh asnjëherë	B) ndodhë në vende të caktuara, ku shkaktohet gradienti më i madh i shpejtësisë së rrjedhjes së gjakut	C) ndodh gjatë temperaturës së ngritur trupore	D) ndodh gjatë lagështisë së madhe të mjedisit	E) ndodh gjatë kushteve të presionit të zmadhuar në mjedis
Metoda indirekte gjerë e shfrytëzuar për matjen e presionit të gjakut është metoda e Riva-Roci. Gjatë realizimit të kësaj procedure në dëgjueset dëgjohe tingulli, që ka të bëjë:	A) rrjedhjen laminare të gjakut	B) rrjedhjen turbulente të gjakut	C) punën e zembrës	D) zmadhimin e temperaturës	E) dallimet në presionet

Shpejtësia e rrjedhjes së gjakut në pjesë të caktuara të sistemit kardiovaskular dallohet dhe ajo për shembull:	A) është më e madhe në aortë sesa në kapilare	B) varet nga presioni atmosferik	C) është më e vogël se sa në kapilare	D) është më e vogël në aortë se sa në vena	E) varet vetëm nga temperatura në pjesët e ndryshme të trupit të njeriut
Në raste të caktuara, rrjedhja gjakut në enët e gjakut përcillet me tingull, që është si pasojë e:	A) rrjedhjen laminare të gjakut	B) rrjedhjen turbulente të gjakut	C) vlerës së ulët të numrit të Reynoldsit	D) koeficientit dinamik të viskozitetit	E) shpejtësisë së zvogëluar të gjakut
Në pajtim me ligjin e Boil Mariotit, gjatë inspiracionit të vëllimit në mushkëritë e bardha zmadhohet:	A) gjatë temperaturës konstante, të përcjellë me zvogëlimin e presionit në mushkëri të bardha deri në vlerën më të vogël se presioni atmosferik	B) gjatë temperaturës konstante, të përcjellë me zvogëlimin e presionit në mushkëri të bardha deri në vlerën më të madhe se presioni atmosferik	C) gjatë temperaturës dhe presioni konstant	D) edhe presioni gjithashtu	E) edhe temperatura gjithashtu
Në procesin e frymëmarrjes, vëllimi i ajrit të inspiruar është:	A) më i madh se vëllimi i ajrit të ekspiruar	B) më i vogël se vëllimi i ajrit të ekspiruar	C) i barabart me vëllimin e ajrit të ekspiruar	D) më i vogël se vëllimi i ajrit të ekspiruar gjatë temperaturës më të ulët se 0 °S	E) asnjë prej përgjigjeve nuk është e saktë
Energjia e metabolizmit shfrytëzohet për funksionimin e organizmit, gjatë kësaj realizohet:	A) vetëm puna e brendshme	B) vetëm puna e jashtme	C) puna e brendshme dhe e jashtme	D) vetëm puna e brendshme mekanike e organeve	E) asnjë prej përgjigjeve nuk është e saktë
Në organizmin e njeriut raporti në mes punës së realizuar dhe energjisë së brendshme është rreth 10%. Si shkak i efikasitetit kaq të ulët janë humbjet e energjisë, që emetohen në rrethinë në formë të:	A) energjia elektrike	B) energjia e ngrohtësisë	C) energjia mekanike	D) energjia kinetike	E) energjia kimike
Shpejtësia e bartjes së energjisë në procesin e përcimit të ngrohtësisë varet nga: përcimi i ngrohtësisë së materialit si dhe nga:	A) gradienti i koncentrimit të dhe sipërfaqes prekëse	B) gradientit të temperaturës dhe sipërfaqes prekëse	C) gradientit të shpejtësisë	D) presionit	E) dhe dendësisë të tij
Nëse trupi i njeriut, për disa shkaqe ka temperatur më të madhe krahas temperaturës normale, enët e gjakut që shpiejnë drejtë lëkurës në masë plotësuese zgjerohen dhe pranojnë sasi më të madhe të gjakut plotësues, me këtë trup:	A) mban teperaturë konstante	B) ftohet	C) ngrohet	D) fillon të lëviz	E) asnjë prej përgjigjeve nuk është e saktë
Procesi i inspirimit dhe ekspirimit të ajrit në mushkëri të bardha është shembull i shkëmbimit të ngrohtësisë me mjedisin përmes:	A) përcim të ngrohtësisë	B) konveksion të lirë	C) kovneksion të detyruar	D) rrezatimit	E) difuzionit
Në kushte normale të rrethit, gjatë procesit të frymëmarrjes, ajri i inspiruar është me:	A) temperaturë më të ulët dhe lagështi më të ulët krahas ajrit të ekspiruar	B) temperaturë më të ulët dhe lagështi më të lartë krahas ajrit të ekspiruar	C) temperaturë më të lartë dhe lagështi më të lartë krahas ajrit të ekspiruar	D) temperaturë më të lartë dhe lagështi më të ulët krahas ajrit të ekspiruar	E) temperaturë të barabartë dhe lagështi më të ulët krahas ajrit të ekspiruar
Oksigjeni nga mushkëritë e bardha, përmes mureve të alveolave bartet në gjak përmes procesit të:	A) osmozës	B) difuzionit	C) përcimit të ngrohtësisë	D) viskozitetit	E) emetimit termoelektronik
Përcakto, cili prej mjediseve të theksuara në organizmin e njeriut më mirë e përçon energjinë elektrike (të drejtë):	A) ashti	B) plazma e gjakut	C) iindi yndyrorë	D) lëkura e thatë	E) flokët dhe thonjtë

Për hulumtimin e veprive elektrike të qelizave, qelizat mund të modelohen me qarkun elektrik në të cilin: shtresat e dyfisht elektrike në dyja anët e membranës janë kondenzator; kanalet të cilat e kontrollojnë kalimin e tipave të ndryshëm të joneve nëpër membranën mund të prezantohen me:	A) kondenzatorin dhe rrezistorit	B) baterinë	C) kondenzatorin kurse citoplazma në brendinë e qelizës ofron rrezistencën plotësuese elektrike dhe prezantohet me rrezistorin	D) rrezistorin kurse citoplazma në brendinë e qelizës e ofron rrezistencë plotësuese dhe prezantohet me rrezistorin	E) kalemën me induktivitet të caktuar
Impedansi Elektrik i indeve është madhësi e cila e paraqet rrezistencën e përgjithshme të tyre që e manifestojnë gjatë rrjedhës së energjisë elektrike të ndryshueshme, dhe kjo ka të bëjë me:	A) rrezistencën dhe induktivitetin e qelizave	B) rrezistencës induktive të qelizës	C) rrezistencën osmotike dhe kapacitative të qelizave	D) rrezistencën induktive dhe kapacitative të qelizave	E) vetëm rrezistencën kapacitative të qelizave
Indet janë të ndërtuara kryesisht nga uji. Për këtë arsye, sipas veçorive magnetike, indet bëjnë pjesë në grupin e:	A) përçuesve elektrik	B) feromagnetikëve	C) diamagnetikëve	D) magnete permanente	E) izolatorë elektrik
Shpejtësia e dritës në një mjedis varet nga madhësitë të cilat i karakterizojnë	A) veçoritë optike, elektrike dhe magnetike	B) veçoritë mekanike	C) veçoritë elastike	D) veçoritë kuantike mekanike	E) veçoritë kimike
Në vakum, përhapja e rrezatimit gama krahas rrezatimit optik, është me	A) shpejtësi më të madhe	B) shpejtësi të njëjtë	C) shpejtësi më të vogël	D) shpejtësia shumë më të vogël	E) shpejtësi shumë më të madhe
Për fotonet me energji të lartë nënkuptohet se kanë edhe	A) gjatësi të madhe valore	B) frekuencë të lartë	C) frekuencë të ulët	D) gjatësi dhe frekuencë të barabartë valore	E) shpejtësi më të madhe se shpejtësia e dritës
Veçoritë optike të mjedisit të caktuar shprehen përmes:	A) gjatësisë valore të dritës	B) frekuencës së dritës	C) indeksit të përthimit në atë mjedis	D) rrezistencës specifike të atij mjedisi	E) impedansit akustik në atë mjedis
Akomodimi i syt ka të bëjë me aftësinë e thjerrzës së syrit:	A) ta ndryshoj indeksin e përthyerjes	B) ta ndryshoj trashësinë	C) të transmetoj gjatësi të caktuara valore të dritës së dukshme	D) të reflektoj gjatësi të caktuara valore të dritës së dukshme	E) ta ndryshoj lakueshmërinë e sipërfaqeve me këtë ndryshohet fuqia e sajë optike
Në procesin e shikimit, drita nga mjedisi bjen në dy, më pas kalon nëpër të duke u përthyer në kufijt me indekse të ndryshme të përthimit, gjatë kësaj më shumë përthet:	A) në kufirin mes mjedisit të jashtëm dhe retinës	B) në thjerrzën e syrit	C) në retinë	D) në trupin qelqor	E) kur do të bie mbi retinë
Energjia e ngrohjes që emetohet nga trupi i njeriut është përmes rrezatimit dhe është nga fusha e:	A) dritës së dukshme	B) dritës infra të kuqe	C) dritës ultra vjollce	D) dritës së verdhë	E) dritës së gjelbër
Rreziqet themelore lidhur me ekspozimin kronik me rrezatim ultra vjollcë janë rreziqet e shfaqjes së:	A) kanceri i lëkurës	B) shfaqjes së kataraktës	C) dëmtimi i sistemit imunologjik të lëkurës	D) tre prej përgjigjeve të ofruara nuk janë të sakta	E) tre prej përgjigjeve të ofruara janë të sakta
Çfarë efekti biologjikdo të shkaktoj drita e laserit mbi një ind do të varet nga:	A) koha e ekspozimit	B) intensitetit të dritës së laserit	C) energjia e dritës së laserit	D) gjatësia e vales së dritës së laserit	E) të gjithë faktorët së bashku
Dallimi i vetëm në mes rrezatimit gama dhe rendgen është në:	A) mënyrën e krijimit të tyre	B) energjitë e tyre	C) efektet e tyre biologjike	D) mekanizmat e ndryshëm të interaksionit me mjedisin material	E) shpejtësitë e tyre të përhapjes mëpër hapësirë

<b>Rrezatimi i Rendgenit fitohet në tubacionin e rendgenit dhe është si pasojë e:</b>	A) ngrohjes së anodës	B) ngrohjes së katodës	C) interaksionit të elektroneve të përshpejtuara nga katoda me bërthamat dhe elektronet e atomeve në anodë	D) interaksioni i elektroneve të përshpejtuara nga anoda me bërthamat dhe elektronet e atomeve nga katoda	E) interaksioni tranzimerik të bërthamave nga atomet e anodës
<b>Në metodat mjekësore ku zbatohet rrezatimi i rendgenit, me zmadhimin e tensionit në tubacionin e rendgenit:</b>	A) zmadhohet depërtueshmëria e rrezatimit rendgen në trupin e pacientit	B) zvogëlohet depërtueshmëria e rrezatimit rendgen në trupin e pacientit	C) nuk ndryshon përbërja spektrale e rrezatimit	D) zmadhohet doza që pranon pacienti në sipërfaqen e lëkurës	E) mund të shkaktohet dukuria e kavitacionit
<b>Në përbërjen e një numri të madh të procedurave radiologjike, shfrytëzohen filtra që kanë për detyrë që të:</b>	A) absorbojnë rrezatimin e fortë rendgen	B) absorbojnë rrezatimin rendgen	C) absorbojnë rrezatimin e fortë dhe të butë rendgen	D) transmitojnë rrezatimin e fortë dhe të butë rendgen	E) fokusojnë duallin rendgenik:
<b>Mënyra dominante e veprimit të ndërsjellët të rrezatimit rendgen me mjedisin material, më rendgen diagnostifikimin realizohet përmes:</b>	A) ndarjes komptonike dhe efektit fotoelektrik	B) efektit fotoelektrik dhe krijimit të çifteve	C) ndarjes së komptonit dhe krijimit të çifteve	D) krijimit të çifteve	E) jonizimit specifik
<b>Rendgeni diagnostika bazohet në:</b>	A) detekimin e rrezatimit rendgen të krijuar në trupin e pacientit	B) shkalla e ndryshme atenuacionit të rrezatimit rendgen, gjatë kalimit nëpër pjesët e ndryshme të trupit të pacientit me Z të ndryshme	C) shkalla e ndryshme atenuacionit të rrezatimit rendgen, gjatë kalimit nëpër indet e ndryshme në organizëm	D) jonizimin të cilin e shkakton rrezatimi rendgen	E) tranzicioni izomer i bërthamave radioaktive të futura në trupin e pacientit
<b>Pacienti i bëhet incizimi radiografik. Pas përfundimit të procedurës, pacienti i theksohet se, menjëherë pas incizimit:</b>	A) lirisht mund të jetë në kontakt me njerëzit	B) duhet të izolohet 2 orë	C) duhet të izolohet 2 ditë	D) nuk guxon të udhëtoj me transportin publik	E) nuk guxon të qëndroj në afërsi të fëmijëve
<b>Në distancën prej 2 m nga një burim radioaktiv, intensiteti i rrezatimit është:</b>	A) dy herë më i vogël krahas intensitetit të sipërfaqes së tij	B) tre herë më i vogël krahas intensitetit të sipërfaqes së tij	C) katër herë më i vogël krahas intensitetit të sipërfaqes së tij	D) intensitet të barabartë me sipërfaqen e tij	E) dy herë më i madh krahas intensitetit të sipërfaqes së tij
<b>Përcakto se gjatë cilës procedurë diagnostifikuese muret dhe dyert e hapësirës duhet të mbështillen me shtresë të plumbit:</b>	A) termografi	B) ehografi	C) EKG	D) rezonanca nukleare magnetike	E) radiografi
<b>Karakteristikat themelore të efekteve skolasitike nga rrezatimi jonizues janë:</b>	A) efekte të vonuara dhe me rritjen e dozës zmadhohet besueshmëria për shfaqjen e këtij efekti	B) shfaqjen menjëherë pas ekspozimit dhe për të njëjtit ekziston kufiri i dozës	C) efekte të vonuara dhe me rritjen e dozës zvogëlohet besueshmëria për shfaqjen e këtij efekti	D) shkaktojnë djegie të lëkurës dhe rritjen e temperaturës së organizmit	E) efekte të hershme dhe për të njëjtit nuk ekziston kufiri i dozës
<b>Karakteristikat themelore të efekteve deterministike nga rrezatimi joizues:</b>	A) shfaqjen menjëherë pas ekspozimit dhe për të njëjtit nuk ekziston kufiri i dozës	B) shfaqjen menjëherë pas ekspozimit dhe për të njëjtit ekziston kufiri i dozës	C) efekte të vonuara dhe me rritjen e dozës zvogëlohet besueshmëria për shfaqjen e këtij efekti	D) kancerogjeneza dhe mutacionet gjenetike	E) efekte të vonuara dhe për të njëjtit ekziston kufiri i dozës
<b>Eksperimentalisht është e konfirmuar se rreziku nga radiacionit është i lidhur me tipin e rrezatimit. Rretho cili prej tipave të theksuar të rrezatimit është me rrezik më të vogël të radiacionit</b>	A) Alfa rrezatimi	B) Rrezatimi Gama dhe rendgen	C) Neutronik	D) Protonik	E) Jone të rënda

<b>Pacientit i bëhet scintigrafia e ndonjë organi. Pas përfundimit të procedurës, menjëherë pas incizimit pacienti:</b>	A) informohet se lirisht mund të jetë në kontakt me njerëzit	B) merr udhëzimin për kohën e nevojshme dhe mënyrën e izolimit, në pajtim me tipin dhe aktivitetin e izotopit të aplikuar gjatë procedurës	C) është stacionuar në bunkerë të specializuar në kohëzgjatje prej 2 ditëve	D) është stacionuar në bunkerë të specializuar në kohëzgjatje prej 3 ditëve	E) është stacionuar në bunkerë të specializuar në kohëzgjatje prej 4 ditëve
<b>Rrumbullako në cilën prej metodave të theksuara mjekësore, pas zbatimit të procedurës, pacienti është i kontaminuar dhe paraqet burim të rrezatimit radioaktiv:</b>	A) radiografi	B) rezonancë nukleare magnetike	C) scintigrafi	D) sonografi	E) termorafi
<b>Radiozotopi i cili futet në trupin e pacientit, në përbërjen e procedurës emetuese monofotonike tomografike është:</b>	A) alfa emituesi	B) beta plus emituesi	C) gama emituesi	D) beta minus emituesi	E) gama emituesi me periudhë të gjysmë shpërbërjes prej disa viteve
<b>Radiozotopi që futet në trupin e pacientit, në përbërjen e procedurës emetuese pozitron tomografike është:</b>	A) alfa emituesi	B) beta plus emituesi	C) gama emituesi	D) beta minus emituesi	E) gama emituesi me periudhë të gjysmë shpërbërjes prej disa viteve
<b>Koha për të cilën radioizotopi i futur në trupin e pacientit gjatë një procedure mjekësore, do të zvogëlohet për gjysmë shprehet me:</b>	A) konstantën e shpërbërjes radioaktive të izotopit	B) periudhën efektive të gjysmë shpërbërjes	C) periudhën biologjik të gjysmë shpërbërjes	D) periudhën fizike të gjysmë shpërbërjes	E) periudhën kimike të gjysmë shpërbërjes
<b>Kriteri kryesor i metodës eksterne radio terapeutike është:</b>	A) gjendjes psikologjike të pacientit	B) shpërndarja në thellësi e dozës së rrezatimit	C) faktori ekonomik	D) madhësia e tumorit	E) koha e rrezatimit
<b>Në metodën eksterne radio terapeutike, për rrezatim të tumoreve të vendosur në thellësi të mëdha, shfrytëzohen:</b>	A) alfa thërmi	B) pozitrone	C) alfa thërmi me energji të larta	D) fotone me energji të ulëta	E) fotone me energji të larta
<b>Pacienti i ekspozuar me metodën eksterne radio terapeutike me fotone me energji të lartë. Pas përfundimit të trajtimit, pacientit i tërhiqet vëmendja se:</b>	A) lirshëm mund të jetë në kontakt me njerëzit	B) duhet të izolohet 2 orë	C) duhet të izolohet 2 ditë	D) ditët e izolimit varen nga energjia e fotoneve	E) ditët e izolimit varen nga gjatësia e tretmanit